



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 5/ 13 Prot.

Tiranë, më 15.07.2026

V E N D I M

Nr. 194, Datë 15.07.2026

Mbështetur në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr.05 Regj., datë 05.01.2026, nga znj. A. B., (në vijim ankuesja) kundër Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore³, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e depozituara pranë Komisionerit, ankuesja pretendon diskriminim nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në lidhje me trajtimin e ndjekur prej këtij institucioni pas aksidentit në punë të datës 11.04.2025.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesja ka paraqitur pranë KMD-së edhe dy ankesa të tjera të ndërlidhura me të njëjtën ngjarje dhe me të njëjtat shkaqe, përkatësisht ndaj drejtueses së institucionit arsimor “Dora d’Istria” dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Të tria procedurat lidhen me të njëjtat fakte dhe rrethana, ku ankuesja pretendon se veprimet ose mosveprimet e subjekteve të përfshira kanë sjellë trajtim të pabarabartë dhe viktimizues pas ushtrimit të të drejtave të saj ligjore. Sipas ankueses, institucionet përkatëse kanë transferuar përgjegjësinë ndërmjet tyre, duke mos i garantuar një mbrojtje efektive dhe duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, paaftësisë së përkohshme në punë si pasojë e aksidentit dhe ushtrimit të të drejtave të saj ligjore.

Më datën 11.04.2025, gjatë orarit të punës, ankuesja u aksidentua në shkallët e shkollës për shkak të gjendjes së dëmtuar të tyre, duke pësuar frakturë në shpatullën e djathtë. Pavarësisht afërsisë së drejtoreshës me vendin e ngjarjes, nuk iu dha ndihma e parë, nuk u njoftua mjeku i shkollës, ambulanca apo qendra shëndetësore dhe transporti drejt Spitalit të Traumës u siguria nga bashkëshorti. Këto rrethana, sipas ankueses, nuk u pasqyruan në mënyrë të plotë në aktet e Inspektoratit të Punës. Gjatë periudhës së raportit mjekësor, ankuesja pretendon se u kontaktua vazhdimisht nga drejtuesit e shkollës, u detyrua të paraqitej në punë për disa ditë pavarësisht paaftësisë së dokumentuar dhe iu kërkua të kryente detyra që lidhnin me periudhën kur ishte me raport mjekësor. Gjithashtu, raportet mjekësore nuk u trajtuan dhe nuk u paguan si aksident në punë. Ankuesja pretendon se gjatë procedurës së ndjekur nga Inspektorati i Punës nuk u mor deklarimi i saj si e dëmtuar, nuk u administruan prova të rëndësishme (si dëshmitë e personave të pranishëm dhe pamjet filmike), procesverbali i aksidentit u hartua jashtë afatit ligjor dhe vendimet e nxjerra sanksionuan shkeljet vetëm me këshillim ose paralajmërim. Sipas saj, është përjashtuar nga procedura, është privuar nga informacioni dhe dokumentacioni për disa muaj dhe është trajtuar në mënyrë më të pafavorshme se punëdhënësja. Ankuesja thekson se, ndryshe nga raste të ngjashme të trajtuara nga Inspektorati i Punës, ku janë vendosur gjopa administrative ndaj punëdhënësve, në rastin e saj nuk janë marrë masa efektive ndaj drejtoreshës. Ajo pretendon se ky trajtim i diferencuar përbën viktimizim në kuptim të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Si pasojë e kësaj sjelljeje, ankuesja pretendon se ky aksident nuk u njoh si aksident në punë nga ISHPSSH. Raportet mjekësore nuk u paguan rregullisht. Në muajt shtator dhe tetor 2025, si pasojë e situatës së krijuar dhe moskorrigjimit në kohë të shkeljeve, nga paga e saj janë mbajtur padrejtësisht 2.000 lekë të rinj në muaj; korrigjimi është bërë vetëm për muajin nëntor pas ankesave të përsëritura pranë drejtoreshës. Ky fakt përbën pasoja të drejtpërdrejta dhe të matshme të viktimizimit.

Përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, konstatimin e trajtimit të pabarabartë procedural dhe joproporcional në veprimtarinë e një autoriteti publik, garantimin që raste të ngjashme të trajtohen mbi kritere objektive, të barabarta dhe ligjore dhe marrjen e masave

për të garantuar që palët e dëmtuara të përfshihen realisht në procedura, të respektohet e drejta për informim dhe dokumentacion dhe të mos përsëritet praktika e përdorur.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a, të LMD, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e pretenduara nga pala ankuese, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Me shkresën nr. 5/2 prot., datë 12.01.2026, u kërkua nga Komisioneri që ankuesja të paraqesë shpjegime të detajuara mbi shkaqet e pretenduara të diskriminimit, duke përcaktuar qartë karakteristikën apo veçantinë që ajo pretendon se mbart dhe që mund të ketë ndikuar në trajtimin e pretenduar diskriminues, të mbështetura me fakte dhe prova konkrete, si dhe të sqarojë lidhjen ndërmjet këtij shkakut dhe pasojave të përjetuara; gjithashtu, të japë informacion nëse i ka adresuar më parë këto shqetësime pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke vënë në dispozicion kopje të ankesës dhe përgjigjes përkatëse, nëse çështja po ndiqet në rrugë gjyqësore duke paraqitur kopje të kërkesë-padisë, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës, duke siguruar që ai të jetë i plotë, i qartë dhe i lexueshëm.

Me shkresën nr. 4/3 prot., datë 22.01.2026, znj. A. B., në cilësinë e ankueses, paraqiti pranë Komisionerit informacion dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të ankesës së saj, duke plotësuar kërkesat e bëra në kuadër të shqyrtimit paraprak të çështjes.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar dhe është pranuar për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara në nenin 33, pika 4, të këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen dhe ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 5/3 prot., datë 14.01.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
- Me email të datës 28.01.2026, si dhe me shkresën nr. 95/1 prot., datë 28.01.2026, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka përcjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të njëjtin informacion dhe dokumentacion, në përgjigje të kërkesës së bërë me shkresën nr. 5/3 prot., datë 14.01.2026, në lidhje me këtë çështje, si më poshtë vijon:

Në lidhje me aksidentin në punë të ndodhur më datë 11.04.2025 në shkollën 9-vjeçare “Dora d’Istria”, ku ka mbetur e dëmtuar mësuesja znj. A. B., ju informojmë se ky aksident është njoftuar pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) më datë 14.04.2025, në adresën zyrtare elektronike info@sl.gov.al, nga drejtoria e institucionit arsimor.

Menjëherë pas marrjes së këtij njoftimi, ISHPSHSH ka vijuar me trajtimin dhe hetimin e rastit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bashkëlidhur gjenden dokumentet e mëposhtme:

- *Autorizim Inspektimi me nr. ISHPSHSH-TR-2025-001747-1, datë 15.04.2025;*
- *Procesverbal Inspektimi me nr. ISHPSHSH-TR-2025-001747-2, datë 30.04.2025;*
- *Listë Verifikimi me nr. ISHPSHSH-TR-2025-001747-2/2, datë 30.04.2025;*
- *Listë Verifikimi për Aksident në Punë me nr. ISHPSHSH-TR-2025-001747-2/1, datë 30.04.2025;*
- *Vendim Përfundimtar i Inspektimit me nr. ISHPSHSH-TR-2025-905241-001747-5, datë 28.05.2025;*
- *Procesverbal Aksidenti në Punë i ISSH-së.*

Sqarojmë se veprimtaria inspektuese e ISHPSHSH-së në terren, nga pikëpamja procedurale, bazohet në Ligjin nr. 10433/2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), i cili përcakton afatet dhe rregullat procedurale mbi të cilat ushtrojnë kompetencat e tyre të gjitha inspektoratet. Ndërkohë, procesi i inspektimit, përfshirë në këtë rast hetimin dhe trajtimin e

aksidentit në punë, është realizuar në përputhje me kompetencat ligjore që legjislacioni i punës i njeh inspektorit të punës.

Në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, sqarojmë se, pas njoftimit të aksidentit, shkaku i ndodhjes së tij ka qenë i qartë dhe i verifikueshëm, bazuar në konstatimet faktike të kryera në vendngjarje. Në përfundim të hetimit, inspektorët e punës e kanë klasifikuar rastin si “aksident në punë”.

Në këtë kontekst, theksojmë se prova materiale, konkretisht gjendja e dëmtuar e shkallëve të brendshme të institucionit, ka pasur peshë vendimtare në vlerësimin e rrethanave të aksidentit dhe në përcaktimin e lidhjes shkakësore me kushtet e punës. Për rrjedhojë, mungesa e marrjes së dëshmive nga dëshmitarët nuk cenon ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e hetimit administrativ të kryer.

Pas trajtimit të aksidentit në punë, znj. B. depozitoi një ankesë pranë institucionit tonë më datë 30.07.2025, në adresën zyrtare info@slj.gov.al, ku ngrinte pretendime në lidhje me mospagesën e raporteve mjekësore sipas parashikimeve ligjore në rastet e paaftësisë për shkak të aksidentit në punë. Në përfundim të trajtimit të ankesës, me shkresën nr. 4183/3 prot., datë 23.09.2025, znj. B., është informuar lidhur me pretendimet e ngritura (shkresa bashkëlidhur).

Për sa i përket afateve të kthimit të përgjigjeve ndaj ankesave të depozituara, ju informojmë se procedurat e inspektimit janë kryer në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar, hyrë në fuqi më datë 16.05.2025), dhe kthimi i përgjigjeve është i lidhur me kohëzgjatjen e procedurave të inspektimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Megjithatë, sqarojmë se znj. B., është informuar brenda afateve ligjore pas inspektimeve të kryera në të dy subjektet.

Në lidhje me vendimmarrjen e inspektorëve, sqarojmë se inspektimi për shkak të aksidentit në subjektin “Dora d’Istria” ishte një inspektim i parë për këtë subjekt. Për shkeljen e konstatuar, subjektit i është vendosur dënimi administrativ kryesor “Paralajmërim”, në përputhje me nenin 44, pika 1, të Ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), sipas të cilit: “Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit”.

Kërkesa për informacion lidhur me korrigjimin e mbajtjes së padrejtë të pagës në muajt shtator–tetor 2025, sqarojmë se ky pretendim nuk ka qenë objekt ankese nga znj. B., pranë institucionit tonë në ankesën e depozituar më datë 12.11.2025. Objekti i kësaj ankese ishte mosmarrja e masave nga ana e subjektit “Dora d’Istria” për zbatimin e detyrave të lëna nga institucioni ynë, konkretisht në lidhje me sistemimin e dyshemesë dhe vendosjen e shiritave parandalues kundër rrëshqitjes.

- Me shkresën nr.5/5 prot., datë 04.02.2026 të Komisionerit i është përcjellë palës ankuese shkresa nr. 95/1 prot., datë 28.01.2026, për të bërë parashtrimet e saj në lidhje me këtë përgjigje.

Nga ana e ankueses u dërguan me email 06.03.2026 parashtrimet dhe kundërshtimet e saj në lidhje me qëndrimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Bazuar në nenin 33, pika 8, të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe me qëllim sqarimin e plotë të fakteve dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri, caktoi datën 02.04.2026, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore, duke njoftuar palët me shkresën nr. 5/6 prot., datë 17.03.2026.

Seanca dëgjimore e datës 02.04.2026 u zhvillua vetëm me praninë e palës ankuese, ndërsa Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nuk mori pjesë. Gjatë kësaj seance, pala ankuese parashtoi pretendime të detajuara lidhur me procedurën e ndjekur nga ky institucion.

Në vijim të procedurës administrative dhe pas mungesës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në seancën e datës 02.04.2026, me shkresën nr. 5/9 prot., datë 05.04.2026, iu kërkuar këtij institucioni informacion shtesë për sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 05 Regj., datë 05.01.2026, paraqitur nga znj. A. B., e cila pretendon diskriminim në formën e viktimizimit për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Për shkak të nevojës për sqarimin e mëtejshëm të pretendimeve të ngritura gjatë seancës, si dhe me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, u vlerësua e arsyeshme caktimi i një seance tjetër dëgjimore në datën 06.05.2026, për të cilën palët u njoftuan nëpërmjet email-it të datës 20.04.2026.

Nëpërmjet email-it drejtuar palëve, u bë me dije se, për arsye objektive institucionale, seanca dëgjimore e planifikuar për datën 06.05.2026, ora 10:00, nuk do të zhvillohej. Gjithashtu, palët u njoftuan se data dhe ora e re e seancës dëgjimore do të komunikoheshin në një moment të dytë. Bashkëlidhur këtij email-i iu përcollën Inspektoratit edhe pretendimet dhe parashtrimet e palës ankuese, me qëllim fillimin e procedurës së ballafaqimit ndërmjet palëve.

Në vijim, me email-in e datës 08.05.2026, palët u njoftuan se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 26.05.2026, ora 10:00, në mjediset e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Seanca dëgjimore e datës 26.05.2026 u zhvillua me praninë e palës ankuese, znj. A. B., si dhe të përfaqësuesve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Gjatë seancës, palët mbajtën në thelb të njëjtin qëndrim me atë të paraqitur më parë në komunikimet dhe parashtrimet e tyre zyrtare të administruara në dosjen e shqyrtimit.

Nga ana e përfaqësuesve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore u paraqit një sqarim i detajuar mbi funksionimin e institucionit, procedurat dhe praktikën e ndjekur në procesin e inspektimit, si dhe u dhanë shpjegime të hollësishme lidhur me trajtimin e rastit konkret,

veprimet e ndërmarra nga inspektorët përgjegjës, dokumentacionin e administruar dhe arsyetimin mbi masat e marra në kuadër të kompetencave ligjore të institucionit. Gjithashtu, përfaqësuesit e Inspektoratit iu përgjigjën pretendimeve të ngritura nga pala ankuese dhe paraqitën argumentet e tyre lidhur me mënyrën e trajtimit të çështjes. Në përfundim të seancës, palët depozituan edhe parashtrime shtesë me shkrim, të cilat iu bashkëlidhën dosjes administrative.

Në vijim të procedurës administrative, pala ankuese depozitoi përsëri pranë Komisionerit argumentet dhe pretendimet e saj lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, si dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të tyre. Këto materiale u administruan në dosjen e çështjes.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, si dhe në analizë të legjislacionit poshtëcituar, Komisioneri vlerëson se:

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Ai vepron për të garantuar respektimin e të drejtave të punëmarrësve, përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurimin e cilësisë së shërbimeve sociale për qytetarët.

Veprimtaria e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore mbështetet në Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, të ndryshuar; Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ndryshuar; si dhe Ligjin nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

Fusha e përgjegjësisë së ISHPSHSH-së përfshin kontrollin e zbatimit të legjislacionit të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, parandalimin e punës së padeklaruar, mbrojtjen e punëmarrësve, si dhe inspektimin e institucioneve publike dhe private që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, për të verifikuar respektimin e standardeve dhe kërkesave ligjore në këtë sektor.

Nga aktet e depozituara dhe pohimet e palëve në këtë proces, rezulton se:

Më datë 11.04.2025, rreth orës 11:15, znj. A. B., me detyrë mësuese pranë shkollës 9-vjeçare “Dora d'Istria”, Tiranë, pësoi një aksident në punë gjatë ushtrimit të detyrës. Sipas rrethanave të referuara nga ankuesja, ajo rrëshqiti dhe u rrëzua në shkallët e katit të dytë të institucionit arsimor, duke pësuar frakturë të shpatullës. Ankuesja pretendon se menjëherë pas ngjarjes nuk iu dha ndihma e

parë nga personeli i shkollës dhe se u detyrua të transportohej vetë drejt Spitalit Universitar të Traumës në Tiranë për marrjen e ndihmës mjekësore.

Më datë 14.04.2025, shkolla 9-vjeçare “Dora d'Istria” njoftoi Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) lidhur me aksidentin në punë të ndodhur ndaj znj. B. Njoftimi u administrua pranë adresës elektronike zyrtare të institucionit, info@sl.gov.al. Nga dokumentacioni rezulton se ky njoftim është kryer tre ditë pas ngjarjes, duke tejkaluar afatin ligjor të parashikuar për raportimin e aksidenteve në punë. Ky fakt është evidentuar dhe në Aktin Përfundimtar të Konstatimit të datës 28.05.2025 të hartuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ku është konstatuar se: *Ligji 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, neni 30, pika 2: Aksidenti në punë i rregjistruar nga punëdhënësi sipas ligjit raportohet Dr/Rajonale vendore të inspektimit në punësim dhe drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore në juridiksionin e të cilave ushtron veprimtarinë e tij punëdhënësi. Konstatimet e detajuara: Raportimi i aksidentit në punë e ka kaluar afatin 24 orë.*

Në vijim të këtij njoftimi, më datë 15.04.2025, ISHPSHSH autorizoi kryerjen e një inspektimi jashtë programit të punës, duke marrë shkas nga lloji i aksidentit dhe institucioni, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse mbi inspektimin. Me autorizimin përkatës u caktua grupi inspektues i përbërë nga inspektorët B. S., M. M., dhe A. N., me afat fillestar të zhvillimit të procedurës deri më datë 23.04.2025.

Më datë 16.04.2025, grupi i inspektimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar nga ISHPSHSH u paraqit pranë shkollës 9-vjeçare “Dora d'Istria” për kryerjen e verifikimeve në terren lidhur me aksidentin në punë të ndodhur më datë 11.04.2025 ndaj znj. A. B. Gjatë kësaj date u krye këqyrja e vendit të ngjarjes, u verifikuan kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, u administrua dokumentacioni fillestar i disponueshëm nga subjekti dhe u përpilua akt-konstatimi përkatës mbi gjetjet e evidentuara gjatë kontrollit.

Nga aktet e dosjes rezulton se gjatë datave 22.04.2025, 23.04.2025 dhe 24.04.2025 është ngritur çështja e paraqitjes së ankueses në vendin e punës gjatë periudhës së paaftësisë së përkohshme për punë.

Rezulton gjithashtu se, më datë 24.04.2025, me shkresën nr. 1699/3 prot., ISHPSHSH Tiranë i është drejtuar Spitalit Universitar të Traumës me kërkesë për administrimin e kartelës mjekësore dhe dokumentacionit shëndetësor të ankueses, me qëllim plotësimin e hetimit administrativ mbi aksidentin në punë.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se në të njëjtën datë ankuesja është paraqitur pranë Spitalit Universitar të Traumës për të tërhequr epikrizën mjekësore, e cila në atë moment nuk ishte ende e përgatitur. Gjithashtu, nga aktet e dosjes rezulton se ankuesja ka komunikuar me një përfaqësues të ISHPSHSH-së, i cili e ka informuar se paraqitja e menjëhershme e epikrizës nuk

përbënte detyrim në atë fazë të procedurës administrative, pasi administrimi i dokumentacionit mjekësor vijonte në kuadër të hetimit të rastit.

Për shkak të nevojës për administrimin e dokumentacionit shtesë dhe kryerjen e verifikimeve të mëtejshme, autorizimi i inspektimit është shtyrë deri më datë 30.04.2025, në përputhje me nenin 37, pika 3, të ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga dokumentacioni rezulton se më datë 25.04.2025 ankuesja është pajisur me raport mjekësor 30-ditor nga mjeku i familjes. Nga aktet e administruara evidentohet se, në të njëjtën periudhë, ankueses iu komunikua nga ana e zyrës arsimore se aksidenti nuk ishte deklaruar pranë organeve të sigurimeve shoqërore brenda afatit ligjor prej 72 orësh. Lidhur me këtë, ankuesja ngriti çështjen e mosdeklarimit të aksidentit, duke kundërshtuar këtë qëndrim dhe duke pretenduar se detyrimi ligjor për raportimin e aksidentit në punë i përkiste punëdhënësit dhe jo punëmarrësit.

Më datë 30.04.2025, grupi inspektues përfundoi veprimet e verifikimit në terren dhe administroi procesverbalin e inspektimit si dhe listë-verifikimin përkatës, duke formalizuar rezultatet e kontrollit administrativ.

Më datë 05.05.2025, pranë ISHPSHSH u administrua përgjigjja e Spitalit Universitar të Traumës lidhur me dokumentacionin mjekësor të kërkuar me shkresën nr. 1699/3 prot., datë 24.04.2025.

Më datë 26.05.2025, znj. B., u rikthye në punë pas përfundimit të periudhës së raportit mjekësor. Një ditë më vonë, më datë 27.05.2025, inspektorja B. S., komunikoi me ankuesen dhe konstatoi se ajo ishte rikthyer në ushtrimin e detyrës.

Më datë 28.05.2025, ISHPSHSH nxori Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. ISHPSHSH-TR-2025-001747-5, me të cilin u konstatua ekzistenca e disa shkeljeve të legjislacionit të punës dhe sigurisë në punë nga subjekti i inspektuar. Konkretisht u evidentua mungesa e shiritave kundër rrëshqitjes në shkallë, dëmtime fizike në strukturën e shkallëve, mungesa e dokumentit të vlerësimit të rrezikut, mungesa e regjistrit të punëmarrësve dhe raportimi i aksidentit jashtë afatit ligjor. Në zbatim të kuadrit ligjor, ndaj subjektit me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr.2025-001747-5 prot., datë 28.05.2025 u vendos masa administrative “*Paralajmërim*”, ndërsa u lanë detyra konkrete korrigjuese për eliminimin e shkeljeve të konstatuara deri më datë 16.06.2025.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, më datë 03.07.2025, ISHPSHSH ka përcjellë dokumentacionin e aksidentit në punë, përfshirë procesverbalin e aksidentit dhe atë të inspektimit, pranë strukturave kompetente të sigurimeve shoqërore për vijimin e procedurave përkatëse.

Në vijim, ankuesja ka paraqitur disa ankesa dhe kërkesa për informacion pranë ISHPSHSH-së lidhur me moslikuidimin e pagesës së raportit mjekësor në masën 100%, si dhe me zbatimin e detyrave të lëna ndaj subjektit të inspektuar. ISHPSHSH ka administruar këto kërkesa, ka vijuar

komunikimin me ankuesen dhe e ka informuar lidhur me veprimet e ndërmarra, kompetencat institucionale dhe vijimin e procedurave të verifikimit.

Nga aktet rezulton se ISHPSHSH ka kryer verifikime pasuese më datë 18.09.2025 dhe 09.12.2025 lidhur me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet administrative të mëparshme. Përfundimisht, me shkresën nr. 5294/4 prot., datë 23.12.2025, të komunikuar ankueses më datë 25.12.2025, ISHPSHSH ka paraqitur rezultatet e verifikimeve të kryera, duke sqaruar se procedurat e inspektimit ishin zhvilluar në përputhje me ligjin nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, se ndaj subjektit ishte vendosur masa administrative “Paralajmërim”, ndërsa çështjet që lidhen me pagesat dhe përfitimet ekonomike duhej të ndiqeshin në përputhje me procedurat dhe kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Më datë 05.01.2026, znj. A. B., paraqiti pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesën nr. 05, duke pretenduar se ishte diskriminuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) për shkak të gjendjes së saj shëndetësore dhe për çdo shkak tjetër të mbrojtur nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit nga ana e ISHPSHSH-së, konstatimin e trajtimit të pabarabartë procedural dhe joproporcional në veprimtarinë e këtij autoriteti publik, si dhe garantimin që raste të ngjashme të trajtohen mbi bazën e kriterëve objektive, të barabarta dhe ligjore. Gjithashtu, ajo kërkon marrjen e masave për të siguruar përfshirjen reale të palëve të dëmtuara në procedurat administrative, respektimin e të drejtës për informim dhe akses në dokumentacion, si dhe parandalimin e përsëritjes së praktikave të përdorura më parë.

Në vijim të procedurës administrative pranë Komisionerit, më datë 28.01.2026, ISHPSHSH paraqiti qëndrimin e saj institucional dhe parashtimet me shkrim, nëpërmjet të cilave argumentoi se nuk ekzistonte asnjë element diskriminimi, trajtimi më pak të favorshëm apo viktimizimi ndaj ankueses. Institucioni parashtroi se kishte ushtruar kompetencat e veta në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme brenda afateve ligjore, kishte kryer inspektime dhe verifikime të shumta, kishte evidentuar shkelje konkrete ndaj subjektit të inspektuar, kishte vendosur masa administrative dhe kishte garantuar komunikim të vazhdueshëm me ankuesen. Për rrjedhojë, ISHPSHSH kërkoi që ankesa të vlerësohej e pabazuar në aspektin e pretendimeve për diskriminim dhe viktimizim.

Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe faktet e administruara gjatë procesit, Komisioneri vlerëson se:

Mbështetur në faktet e administruara gjatë hetimit administrativ, dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe kuadrin ligjor në fuqi, Komisioneri vlerëson se analiza e rastit duhet të fokusohet në përcaktimin nëse veprimet dhe mosveprimet e pretenduara të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) përbëjnë trajtim më pak të favorshëm, diferencues ndaj ankueses për shkak të gjendjes së saj shëndetësore dhe nëse jemi në kushtet e viktimizimit.

Nga shqyrtimi i kuadrit ligjor rezulton se ISHPSHSH ushtron kompetencat e tij në bazë të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, të ndryshuar; Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ndryshuar; si dhe Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Këto dispozita i ngarkojnë këtij institucioni përgjegjësinë për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit të punës, të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të verifikuar respektimin e standardeve ligjore nga punëdhënësit dhe për të ndërmarrë masa administrative në rastet kur evidentohej shkelje.

Në rastin konkret rezulton se, menjëherë pas administrimit të njoftimit për aksidentin në punë në datën 14.04.2025, ISHPSHSH ka vënë në lëvizje mekanizmat ligjorë të kontrollit administrativ. Më datë 15.04.2025 është autorizuar inspektimi jashtë programit për arsye të llojit të rastit të raportuar si aksident në punë dhe më datë 16.04.2025 grupi inspektues është paraqitur pranë subjektit për kryerjen e verifikimeve në terren. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se gjatë kësaj procedure janë kryer këqyrje të vendit të ngjarjes, janë administruar dokumente, janë evidentuar kushtet infrastrukturore të objektit dhe është përpiluar akt-konstatimi përkatës në vendngjarje.

Nga procesverbali i inspektimit, listë-verifikimi dhe vendimi përfundimtar i datës 28.05.2025 rezulton se ISHPSHSH ka evidentuar së pari se ngjarja e ndodhur në datën 11.04.2025 është cilësuar si aksident në punë, duke konstatuar mungesën e shiritave kundër rrëshqitjes, dëmtime në shkallë, mungesën e dokumentit të vlerësimit të rrezikut, mungesën e regjistrit të punëmarrësve dhe raportimin me vonesë të aksidentit në punë. Këto konstatime janë pasqyruar në aktet administrative të institucionit dhe kanë çuar në vendosjen e masës administrative “Paralajmërim” ndaj subjektit të inspektuar.

Fakti që organi inspektues ka konstatuar shkelje dhe ka marrë masa administrative ndaj subjektit të kontrolluar përbën tregues se procedura e kontrollit nuk ka qenë formale apo e njëanshme, por është ushtruar në përputhje me funksionin e tij ligjor mbikëqyrës. Në këtë kuptim, pretendimi se institucioni ka favorizuar subjektin e inspektuar nuk gjen mbështetje në aktet administrative të administruara.

Këto veprime përbëjnë ushtrim të drejtpërdrejtë të kompetencave ligjore të ISHPSHSH-së dhe nuk rezulton që ankuesja të jetë përjashtuar nga procedura apo të jetë trajtuar ndryshe nga çdo punëmarrës tjetër që raporton një aksident në punë. Përkundrazi, procedura administrative është iniciuar dhe zhvilluar si pasojë e aksidentit të raportuar dhe jo si rezultat i ndonjë kriteri personal të ankueses.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe i shpjegimeve të dhëna gjatë procedurës administrative, Komisioneri konstaton se rasti i ankueses A. B., nuk mund të konsiderohet i

krahasueshëm me rastin e aksidentit në punë të ndodhur në shkollën 9-vjeçare “7 Marsi”, Tiranë, pasi çdo rast i aksidentit në punë vlerësohet individualisht mbi bazën e rrethanave konkrete, provave të administruara dhe shkeljeve të konstatuara. Në këtë kuadër, vendimmarrja për masat administrative dhe trajtimin e pasojave ligjore bëhet rast pas rasti, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, diskrecionin e njohur me ligj dhe rrethanat specifike të secilit subjekt, përfshirë edhe faktin nëse ai është përsëritës i shkeljeve. Komisioneri konstaton gjithashtu se, për rastin e ankueses A. B., Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer verifikimet përkatëse brenda afateve ligjore, ka konstatuar ekzistencën e një aksidenti në punë dhe ka evidentuar shkelje të rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke marrë masat administrative në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes.

Nga verifikimi i praktikës së ndjekur për rastin e shkollës 9-vjeçare “7 Marsi”, Tiranë, rezulton se është zbatuar e njëjta procedurë standarde inspektuese, nëpërmjet kryerjes së verifikimeve dhe administrimit të dokumentacionit përkatës. Në këtë rast nuk rezulton të jetë vendosur masë administrative me gjobë, nuk është administruar deklaratë formale e personit të dëmtuar dhe nuk janë kryer inspektime pasuese. Për rrjedhojë, në bazë të dokumentacionit të administruar, Komisioneri nuk konstaton elemente që të provojnë ekzistencën e një trajtimi të ndryshëm apo të një standardi të dyfishtë në veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Nga dokumentacioni rezulton gjithashtu se ISHPSHSH ka zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me ankuesen pas përfundimit të inspektimit fillestar. Ankesa e datës 30.07.2025 është trajtuar nëpërmjet një sërë komunikimesh elektronike dhe shkresash zyrtare, përfshirë përgjigjet e datave 01.08.2025, 07.08.2025, 08.08.2025, 13.08.2025, 23.09.2025 dhe 23.12.2025. Nga këto komunikime rezulton se ankuesja është informuar vazhdimisht mbi ecurinë e verifikimeve, kompetencat e institucioneve përkatëse dhe rezultatet e procedurave administrative.

Komisioneri vëren se e drejta për informacion dhe e drejta për t’u dëgjuar në procedurë nuk rezultojnë të jenë cenuar. Përkundrazi, ankuesja ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e saj, të depozitojë ankesa të përsëritura dhe të marrë përgjigje zyrtare për secilën prej tyre. Ky element merr rëndësi të veçantë në vlerësimin e pretendimit për viktimizim procedural, pasi nga aktet nuk rezulton që ankueses t’i jetë kufizuar aksesin në procedurë për shkak të ushtrimit të të drejtave të saj.

Lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, KMD vëren se kjo rrethanë ka shërbyer si nxitje për nisjen e inspektimit fillestar, i cili është kryer në vendngjarje më datë 16.04.2025 dhe në vijim, ISHPSHSH ka administruar dokumentacion shtesë mjekësor, ka kërkuar kartelën mjekësore pranë Spitalit Universitar të Traumës dhe ka analizuar rrethanat e aksidentit në punë duke e vlerësuar pikërisht si të tillë. Nuk rezulton që gjendja shëndetësore e ankueses të jetë përdorur si kriter për ta përjashtuar nga një e drejtë, për t’i kufizuar aksesin në procedurë apo për ta trajtuar më pak në mënyrë të favorshme.

Gjithashtu, rezulton se ISHPSHSH ka kryer verifikime pasuese më datë 18.09.2025 dhe 09.12.2025, duke kontrolluar zbatimin e detyrave korrigjuese të lëna subjektit të inspektuar. Gjatë këtyre verifikimeve janë administruar dokumente shtesë, përfshirë korrespondencën e shkollës me Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike pranë Bashkisë Tiranë për ndërhyrjet infrastrukturore në objekt. Kjo tregon se institucioni ka vijuar monitorimin e rastit edhe pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar.

Në raport me pretendimin e ankueses për moslikuidimin e përfitimeve ekonomike nga raporti mjekësor, Komisioneri vëren se vetë ISHPSHSH ka sqaruar vazhdimisht se trajtimi i përfitimeve nga sigurimet shoqërore nuk bën pjesë në kompetencat e tij funksionale. Sipas legjislacionit për sigurimet shoqërore, kompetenca për njohjen dhe likuidimin e përfitimeve ekonomike i takon strukturave të sigurimeve shoqërore. Për rrjedhojë, mospërmbushja e një të drejte që nuk bën pjesë në juridiksionin dhe kompetencat e ISHPSHSH-së nuk mund t'i atribuohet këtij institucioni si veprim apo mosveprim diskriminues. ISHPSHSH ka ushtruar kompetencat e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme brenda fushës së veprimtarisë së tij dhe duke respektuar afatet ligjore të parashikuara. Për këtë arsye, pretendimet që lidhen me çështje jashtë kompetencës së këtij institucioni nuk mund të shërbejnë si bazë për të konstatuar trajtim të pabarabartë apo diskriminues nga ana e tij.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses lidhen kryesisht me mënyrën e ushtrimit të kompetencave administrative, me përmbajtjen e akteve të nxjerra nga ISHPSHSH dhe me vlerësimin administrativ të rastit të aksidentit në punë. Këto pretendime mund të përbëjnë objekt kontrolli administrativ ose gjyqësor sipas legjislacionit përkatës, por nga provat e administruara nuk rezulton të provohet ekzistenca e trajtimit më pak të favorshëm si pasojë e diskriminimit apo viktimizimit në kuptim të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të ndryshuar.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton se Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka refuzuar trajtimin e çështjes së ankueses, ta ketë përjashtuar atë nga procedura administrative, ka mbajtur një qëndrim mosveprues ndaj kërkesave të saj, apo e ka trajtuar ndryshe për shkak të gjendjes së saj shëndetësore ose për ndonjë shkak tjetër të mbrojtur nga ligji. Për rrjedhojë, Komisioneri çmon se pretendimet e ankueses lidhen me kundërshtimin e vlerësimeve dhe përfundimeve administrative të organit inspektues, dhe jo me ekzistencën e fakteve ose rrethanave që provojnë se ajo është diskriminuar në kuptim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ardhur për shkaqet e pretenduara.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32 dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. A. B., kundër Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të *“gjendjes shëndetësore”* dhe *“çdo shkak tjetër”*.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)